



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
MINISTRI

Nr. 4008 Prot.

Tiranë, 02.8.2013

U D H Ë Z I M

Nr. 21, datë 02.8.2013

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR DHËNIEN E  
MEDALJES SË ARTË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2 të nenit 53 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë",


UDHËZOJ:

1. Nxënësve të shkëlqyer në vite, pas përfundimit të arsimit të mesëm të lartë, u jepet "Medalja e artë" nga Presidenti i Republikës, me propozimin e ministrit.
2. Nderohen me medaljen e artë nxënësit, që përfundojnë arsimin e mesëm të lartë, dhe plotësojnë njëherësh këto kushte:
  - a) Kanë pikët mesatare për kredit jo më pak se 10.00.
  - b) Në secilin prej provimeve të detyruara të maturës shtetërore janë vlerësuar me jo më pak se nota e shkallëzuar 9.5.
  - c) Në provimet me zgjedhje të maturës shtetërore kanë mesataren e notave të shkallëzuar 10.00.
  - d) Kanë sjellje shumë të mirë gjatë viteve të shkollimit.
3. Nderohen me medaljen e artë nxënësit që janë fitues të njërit prej tre çmimeve të para në olimpiadat ndërkombëtare me më shumë se 15 vende pjesëmarrëse.

Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi: Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

  
MYQËREM TAJ

